

VLERAT E KUSHTETUTËS DHE ROLI I GJYKATËS KUSHTETUESE NË GARANTIMIN E TYRE

Fjala e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese – z.Bashkim DEDJA

Sesioni i Parë

“Kushtetuta si themel i bashkëjetesës politike dhe shoqërore”

Të nderuar pjesëmarrës,

Para se të ndalem tek roli i Gjykatës Kushtetuese në promovimin e vlerave kushtetuese mbi shtetin e së drejtës, demokracinë, pluralizmin, të drejtat e njeriut, do të them fillimisht dy fjalë mbi Kushtetutën, për të cilën jemi mbledhur këtu sot.

Kushtetutat – që nga ligjet bazë të qytet – shteteve Greke (Polis) dhe deri sot, - përcaktojnë themelet e rendit shtetëror, organizimin dhe rregullimin e institucioneve të shtetit. Nëse gjatë procesit të krijimit të kësaj marrëveshjeje, parimet e konstitucionalizmit mbahen parasysh, marrëdhëniet e përcaktuara me Kushtetutë përcaktojnë një sistem kufizimesh. Kushtetutat kanë të bëjnë me ushtrimin e pushtetit; një Kushtetutë e frymëzuar nga idetë e konstitucionalizmit ka të bëjë me kufizimin e pushtetit.

Aristoteli, themelues i shkencave politike, identifikonte tre dimensionet e çdo kushtetute; *i pari* - është sistemi i qeverisjes, me të cilin jemi më shumë të familjarizuar, dhe që përcakton strukturën, pushtetet dhe funksionet e organeve shtetërore, *i dyti* - është dimensionin socio-ekonomik dhe *i treti* - dimensionin moral, i cili përcakton bazën normative të sistemit kushtetues, përfshirë rregullat e lojës të pranuar në politikë. Çdo kushtetutë moderne, në mënyrë të drejtpërdrejtë, reflekton dimensionin e parë, ndërsa dy dimensionet e tjera, në varësi të llojit të kushtetutës, i reflekton sa drejtpërdrejt, por aq dhe tërthorazi¹.

Termi “kushtetutë” mund të ketë kuptime të ndryshme. Megjithatë, një kuptim i drejtë mbi kushtetutën, kërkon që përkufizimi i saj të përkojë me “kushtetutën e një shteti”, si bashkim politik i njerëzve. Në këtë kuptim, Kushtetuta përshkruan vetë shtetin, formën konkrete të

¹ Michel Rosenfeld, András Sajó, CONSTITUTIONALISM: Foundations for the New Millennium”, botuar në New millennium Constitutionalism Paradigms of reality and challenges; ISBN 978-99930-66-58-3; Yerevan – Armeni, 2013, fq.12.

E disponueshme në: <http://www.concourt.am/armenian/library/cclibrary/2013/newmillenium.pdf>

ekzistencës së tij². Nga ky prizëm, kushtetutat e shteteve të ndryshme mund të jenë të strukturuar në mënyra të ndryshme, zbatohen nëpërmjet një varieteti mekanizmash, u imponohen subjekteve sipas metodave ekzekutive specifike.

Gjithsesi, përtej dallimeve, funksioni kryesor i tyre është përcaktimi i kushteve të bashkëjetesës midis të gjithëve, domethënë, i parimeve substanciale të jetës së përbashkët dhe i rregullave të ushtrimit të pushtetit publik, të pranuar nga të gjithë, që qëndrojnë për këtë arsye jashtë njerëzve. Kushtetuta, nëse i referohemi një pohimi të lashtë dhe shumë të respektuar, përcakton atë që quhet *pactum societatis* (*pakt shoqëror*), sipas të cilit njerëzit merren vesh për kushtet e bashkëjetesës në respekt të ndërsjellë³.

Duke u kthyer tek Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, mund të themi se ajo padyshim promovon vlera demokratike të gjithëpranuar nga vendet evropiane perëndimore dhe demokracitë përparimtare. Në të janë sanksionuar parimet e demokracisë kushtetuese si: shteti i së drejtës, demokracia, pluralizmi, ndarja e pushteteve, të drejtat e njeriut, dinjiteti njerëzor, etj. Që në Preambul identifikohet fryma dhe shpirti që kjo Kushtetutë përçon:

“Ne, populli i Shqipërisë
... me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik dhe social,
për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut...
...vendosim këtë Kushtetutë.”

Kushtetuta ka dhe duhet të ketë si mision kryesor ruajtjen e vlerave themelore demokratike; ajo duhet të promovojë dhe evidentojë këto vlera, si dhe të sigurojë stabilitetin, ashtu si dhe dinamizmin e zhvillimeve shoqërore, forcimin e ndjenjës së drejtësisë në marrëdhëniet njerëzore.

Kushtetuta është norma supreme, kontrollin kushtetues mbi respektimin e të cilës e bën Gjykata Kushtetuese. Kjo gjykatë ka theksuar se Kushtetuta, si ligji themelor i shtetit, detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese nuk mund të mënjanohet

²Carl Schmitt, *Constitutional Theory*, Duke University Press, Durham and London 2008, fq.59.

³Zagrebelsky Gustavo, “Corte in Politica”, *Pubblicato in 23° premio Chiarelli, Corte Costituzionale*, Roma 20 Ottobre 2004.

ose të tejkalohet, duke i dhënë përparësi akteve juridike që dalin në bazë e në zbatim të Kushtetutës⁴.

Gjykata Kushtetuese në mënyrë të vazhdueshme ka evidentuar vlerat kushtetuese nëpërmjet interpretimit kushtetues. Le të përmendim disa nga çështjet. P.sh. në një grup çështjesh, ku kërkuesit pretendonin mosrespektimin e nenit 81/2 të Kushtetutës nga ligjvënësi, për ligje të cilat duhej të miratoheshin me 3/5, kjo gjykatë është shprehur mbi domosdoshmërinë e respektimit të kriterëve formale që vendos Kushtetuta, gjatë procedurës ligjvënëse. Sipas Gjykatës, parimi i shtetit të së drejtës i detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese, prandaj dhe aktet juridike, që nxirren nga këto organe, duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal ashtu edhe atë material⁵.

Ndërsa në një çështje, ku kërkohet konstatimi i papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, Gjykata ka evidentuar se sovraniteti i takon popullit, që e ushtron atë në format dhe brenda kufijve të përcaktuar në Kushtetutë. Nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në Parlament, qytetarëve iu është dhënë mundësia për të marrë pjesë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë në vendimet që marrin organet qendrore kushtetuese, të cilat i shtrijnë efektet tek interesat e tyre. Po sipas Gjykatës, në një demokraci përfaqësuese, qytetarët përfshihen në një proces përzgjedhës të anëtarëve të Parlamentit, proces që mbështetet në ekzistencën e një marrëdhënieje mirëbesimi midis qytetarëve (elektoratit) dhe anëtarëve të Parlamentit. Megjithëse çdo deputet zgjidhet nga një zonë elektorale e caktuar, pasi zgjidhet dhe bëhet pjesë e Parlamentit, ai kryen funksionin e tij si deputet në interes të të gjithë qytetarëve. Çdo qytetar konsiderohet si mbajtës i një copëze të barabartë të sovranitetit, i cili, i marrë në tërësinë e tij, bën të mundur marrjen e vendimeve nga mbajtësi i sovranitetit që është populli, nëpërmjet përfaqësimit të tij nga deputeti⁶.

Demokracia nënkupton që të drejtat e pakicës duhet të mbrohen ashtu sikundër mbrohet vullneti i shumicës. Në një çështje ku iu kërkua shfuqizimi i ligjit për gjendjen civile, për elementin “kombësi”, pasi nuk respektonte të drejtat e pakicave, Gjykata është shprehur se qëllimi i kushtetutëbërësit është që, në shoqërinë shqiptare, të gjithë të jetojnë së bashku në

⁴Vendimet nr.29/2005, nr.16/2007, të Gjykatës Kushtetuese.

⁵Vendimet nr.17/2005, nr.11/2007, nr.18/2008, 23/2011, të Gjykatës Kushtetuese.

⁶Vendimi nr.44/2011 i Gjykatës Kushtetuese.

harmoni, duke njohur vlerat në ndryshimet e dallimet që karakterizojnë pakicën. Në kuadrin kushtetues, një ndër parimet themelore të shtetit të së drejtës, është respekti ndaj të drejtave të pakicave, që jo vetëm nxit kohezionin social, por ndihmon dhe në krijimin e një shoqërie të qëndrueshme, të integruar e multidimensionale, ku të drejtat e njeriut garantohen për të gjithë⁷.

Gjithashtu, në disa çështje të lidhura me zgjedhjet, kësaj Gjykate i është kërkuar shqyrtimi i legjislacionit zgjedhor në përputhje me nenin 3 të Kushtetutës, sipas të cilit pluralizmi është një nga elementet bazë që shteti duhet të mbrojë. Kjo gjykatë ka evidentuar disa elemente të pluralizmit, si: zgjedhjet e lira, të barabarta dhe të ndershme, shumësia e interesave, lejimi i hapësirave për organizimin e mekanizmave të presionit ndaj organeve të pushtetit dhe një shtet që është i përgjegjshëm ndaj nevojave të qytetarëve. Gjykata ka theksuar se dhe partitë politike në sistemin e zgjedhjeve dhe veçanërisht në procesin zgjedhor, që nga fushata parazgjedhore, paraqitja e kandidatëve, formimi i trupave zgjedhore, ndjekja e zgjedhjeve e deri te ndarja e mandateve, paraqiten si një faktor përcaktues shumë i rëndësishëm. Prandaj, sipas saj, demokracia përfaqësuese, ashtu edhe sistemi i zgjedhjeve nuk mund të paramendohet pa ekzistencën dhe funksionimin e partive politike⁸. Ajo ka pranuar se nuk mund të bëhet fjalë për pluralizëm, tolerancë dhe krijim të vullnetit të lirë politik, aq të domosdoshëm për shoqërinë demokratike, nëse nuk garantohet liria e shprehjes si një nga gurët themelore të shtetit demokratik⁹.

Në demokraci, parimi i rëndësishëm i ndarjes dhe i balancimit të pushteteve synon kryesisht të mënjanojë rrezikun e përqendrimit të pushtetit në duart e një organi apo të personave të caktuar, gjë që praktikisht mbart me vete rrezikun e shpërdorimit të tij. Për këtë qëllim, pavarësisht se pushteti shtetëror në tërësi është një dhe i pandarë, brenda tij ka një sërë ndërthurjesh dhe raportesh të ndërsjella që Kushtetuta krijon ndërmjet segmenteve të caktuara të tij. Gjykata Kushtetuese e ka parë këtë parim jo vetëm në aspektin e ndarjes dhe balancimit të tri (3) pushteteve klasike, por edhe në kuadrin e mosndërhyrjes apo qartësimit të kompetencave edhe të organeve të pavarura kushtetuese, që nuk bëjnë pjesë në asnjë nga pushtetet, si Presidenti, Prokurori i Përgjithshëm apo Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

⁷Vendimi nr.52/2011 i Gjykatës Kushtetuese.

⁸ Vendimi nr.28/2012 i Gjykatës Kushtetuese.

⁹ Vendimi nr.16/2004 i Gjykatës Kushtetuese.

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut zënë një vend të posaçëm në Kushtetutë, si të drejta të pandashme, të patjetërsueshme dhe të padhunueshme. Kushtetuta ka një qasje tërësore dhe ka parashikuar nga ana strukturore të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Në një numër të konsiderueshëm vendimesh, Gjykata Kushtetuese ka interpretuar standardet kushtetuese lidhur me gëzimin, dhe garancitë kushtetuese për mbrojtjen e këtyre të drejtave¹⁰.

Kushtetuta është ligji më i lartë në vend, drejtësia kushtetuese e bën atë efektive. Në këtë kontekst, interpretimi i dispozitave të Kushtetutës në praktikën e drejtësisë kushtetuese, natyrisht është i një rëndësie themelore si një faktor në stabilitetin dhe zhvillimin e rendit kushtetues. Gjykata Kushtetuese i ka lexuar normat kushtetuese në harmoni me njëra-tjetrën dhe veçanërisht me ato që sanksionojnë parimin e sovranitetit të popullit dhe shtetit të së drejtës. Është mjaft e njohur nga sistemet kushtetuese, doktrina sipas të cilës, edhe pa ndryshuar Kushtetutën, interpretimi kushtetues (sidomos vendet që kanë Gjykatë Kushtetuese), mund të sjellë ndryshime thelbësore mbi të kuptuarit e normës kushtetuese nën dritën e kushteve dhe rrethanave jetësore të ndryshme.¹¹

Kushtetuta në formën e normës juridike detyruese, organizon shtetin dhe pushtetet dhe, në thelb, përbën aktin përcaktues të kriterëve dhe rregullave të bashkëjetesës brenda një komuniteti të caktuar shoqëror-politik. Arkitektët e Kushtetutës, hartuesit dhe miratuesit e saj, mund të huazojnë mekanizma të ndryshme nga modele kushtetuese të avancuara, por, në analizë të fundit, këto mekanizma duhet të integrohen në atë mënyrë që të jenë të duhura dhe të gjalla për shpirtin e asaj shoqërie të cilës Kushtetuta do t'i përkasë.

Ju faleminderit!

¹⁰ Vendimet nr.65/1999, nr.16/2004, nr.30/2005, nr.20/2006, të Gjykatës Kushtetuese.

¹¹Report on Constitutional Amendments, 11-12 Dhjetor 2009, CDL-AD(2010)001, Komisioni i Venecias, e disponueshme në: [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/CDL-AD\(2010\)001.aspx](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/CDL-AD(2010)001.aspx).